



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PEQIN

Nr. ____ .Prot.

Peqin, më ____/05/2020

NJOFTIM FITUESI PËR DHENIEN ME QIRA

Njoftim fituesi për dhenien me qira të sipërfaqes se fondit pyjor me sipërfaqe 12.5 ha (n/gastra me Nr.pas. 90/4), zona kadastrale 2338, vol 3, faqe 211 e llojit “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Peqin“ për qëllime Agropylltari.

• Autoriteti qiradhënës: Bashkia Peqin, (NJ.Q.V.)
Adresa: Bulevardi “Mustafa Gjinishi”, Peqin, Nr.tel.: 00355698754123, e-mail: info@peqini.gov.al.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9385. datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.1, date 09.06.2016 ”Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” dhe legjislacionit të zbatueshëm për pyjet dhe shërbimin pyjor/fondin kullor, Bashkia e Peqinit ka zhvilluar më datë 15.05.2020 ora 12.00 procedurën e konkurrimit publik për “Dhenien me qira të sipërfaqes se fondit pyjor me sipërfaqe 12.5 ha (n/gastra 90/4), zona kadastrale 2338, vol 3, faqe 213, e llojit “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Peqin“ për qëllime Agropylltari”.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | | |
|----|--------------------------|--|
| 1. | “Benordo” sh.p.k. | K19207105B |
| | Vlera e ofruar e qirasë: | 10,000 (dhjetëmijë) lekë për ha në vit |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm: Nuk ka ofertues të skualifikuar

Në përfundim të vlerësimit, bazuar në pikat 14 dhe 15 të Udhëzimit Nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Bashkia Peqin vendosi të shpallë fituese ofertën e paraqitur nga subjekti “Benordo”, me adrese Lagjia “Xhami“, Rruga “Ismail Kadiu“, Peqin.

Bashkia Peqin njofton subjektin “Benordo” sh.p.k., me adresë Lagjia “Xhami“, Rruga “Ismail Kadiu“, Peqin, Nipt. K19207105B se oferta e paraqitur me datë 15.05.2020, ora 12.00, për marrjen me qira të sipërfaqes te fondit pyjor me objekt “Dhenien me qira të sipërfaqes se fondit pyjor me sipërfaqe 12.5 ha (n/gastra 90/4) zona kadastrale 2338, vol 3, faqe 213, e llojit “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Peqin“ për qëllime Agropylltari”, me masën e qirasë 10,000 (dhjetëmijë) lekë për ha/vit është pranuar si ofertë e suksesshme.

Për sa më sipër, pas përfundimit të afateve të ankimimit parashikuar në pikat 16 dhe 17 të Udhëzimit Nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” ofertuesi “Benordo” sh.p.k. njoftohet të paraqitet pranë Bashkisë Peqin (Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve) për lidhjen e kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **15.05.2020**

Ankesa: **Jo**

KRYETARI I BASHKISË

/ Lorenc TOSKU /